




**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
**Autoriteti i Konkurrencës**  
**Autoritet za Konkurenciju - Competition Authority**



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo - Republic of Kosovo  
Autoriteti i Konkurrencës  
Autoritet za Konkurenciju - Competition Authority  
Nr. i Prot./Br. Prot./Prot. No. 824/24-M/D  
Nr. i Fq./Br. St./No. Pg. 1/7  
Data/Datum/Date: 24.12.2024  
PRISHTINË - PRISHTINA - PRISTINA

Nr. 108/24  
Prishtinë, më 24.12.2024

Në mbështetje të nenit 11 nenit 13, nenit 15, nenit 16 nenit 17, nenit 18, nenit 19, nenit 26, nenit 27, nenit 39, si dhe nenit 55 paragrafi 1, me nën paragrafin 1.5, të Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2023 për Përcaktimin e Tregut Përkatës, Rregulloren Nr. 01/2023 për Procedurat hetimore të Autoritetit të Konkurrencës, Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2023, për Procedurën e Parashtrimit të Kërkesave për Lejimin e Përqendrimit dhe Kriteret për Konstatimin e Përqendrimit, si dhe Udhëzuesin Nr. 02/2023 për Vlerësimin e Përqendrimeve Horizontale, pasi shqyrtoi kërkesën e përfaqësueses ligjore të ndërmarrjes, Dukagjini SH.P.K, të datës 02.09.2024, me Nr. Prot; 557/24-11/H, lidhur me blerjen e 100% të aksioneve nga ndërmarrja, Shtëpia Botuese Libri Shkollor SH.P.K., Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës së Republikës së Kosovës pas shqyrtimit të Raportit të Sekretariatit, në mbledhjen e mbajtur me datën 24.12.2024 merr këtë:

## V E N D I M

**I. LEJOHET** Përqendrimi i ndërmarrjeve lidhur me blerjen e 100% të aksioneve, nga ndërmarrja Dukagjini SH.P.K, me NUI: 810418922, adresa, Rr. Ismail Qemaili, Nr. 2, Pejë, Kosovë, në cilësinë e (blerësit), mbi Shtëpinë Botuese Libri Shkollor, me NUI: 810504630 adresa: Zona Industriale Rr. Ymer Elshani, nr. 51. në cilësinë e (shitësit).

**II. MONITORIMI** - Autoriteti i Konkurrencës, ndërmarrjen Dukagjini SH.P.K., do ta mbajë nën monitorim për një periudhë 3 (tri) vjeçare, për çdo formë të shtrembërimit të konkurrencës, respektivisht sjelljet anti-konkurrese si: vendosja e çmimeve nën kosto, krijimi i barrierave për hyrjen e ndërmarrjeve të reja në treg, nënshkrimin e marrëveshjeve të distribuimit, si dhe çdo veprim tjetër që ka efekt të dëmshëm ose antikonkurrese, pa u kufizuar, në lirinë e shpërndarjes së produkteve, krijimin e barrierave për hyrjen e ndërmarrjeve të reja në treg, ose të krijojnë ndarje të pabarabarta të tregut, do të ndërmerren veprimet ligjore bazuar në Ligjin Nr. 08/L-056, për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Ndërmarrja Dukagjini SH.P.K., t'i dorëzojë në Autoritet:

- 1) **Raport vjetor për politikën e çmimeve** të librave shkollor, para se t'i dorëzojë në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI).
- 2) **Njoftim për çdo libër të licencuar** nga MASHTI dhe çmimi përkatës i tij, menjëherë pas licencimit.
- 3) **Listat e librarive të furnizuara dhe marrëveshjet e distribuimit (shpërndarjes)** me libra shkollor për çdo vit kalendarik.

Autoriteti i Konkurrencës  
Adresa: Rr. Migjeni nr. 21, 10000 Prishtinë. Kati i VI, zyra Nr.1  
Tel: +383 /0/ 38 200 109 82 E-mail: [info.konkurrenca@rks-gov.net](mailto:info.konkurrenca@rks-gov.net)

U.B

F.H.

SGC

4) Pasqyrat financiare vjetore të dorëzuara për çdo vit kalendarik.

**III. OBLIGIMET E PARASHTRUESIT** – Parashtruesi i njoftimit për Përqendrim, obligohet të paguaj taksën administrative prej 1,000.00€ me shkronja (njëmijë euro) dhe Vendimin për Realizimin e Përqendrimit, në përputhje me nenin 55, 1.5 të Ligjit 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe neni 24 të Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2023, bëhet kundrejt pagesës në vlerë prej 6,000.00€ me shkronja (gjashtë mijë Euro).

### A r s y e t i m

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës, me datë: 02.09.2024, me Nr. Prot. 557/24-11/H ka pranuar kërkesën për Njoftimin e Përqendrimit, përmes përfaqësueses ligjore, Vjosa Shkodra, lidhur me blerjen e 100% të aksioneve nga ndërmarrja Dukagjini SH.P.K., në cilësinë e (blerësit) mbi Shtëpinë Botuese Libri Shkollor., në cilësinë e (shitësit).

#### Pjesëmarrësit në Përqendrim:

**Dukagjini SH.P.K.**, është themeluar dhe regjistruar në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (ARBK), me Numër Unik Identifikues (NUI) 810418922, dhe zyrë të regjistruar në adresën, Rr. Ismail Qemali, Nr. 2, Pejë, Kosovë. Aktivitetet e ndërmarrjes përfshijnë sektorin e botimit dhe shitjes së librave në territorin e Republikës së Kosovës.

**Shtëpia Botuese Libri Shkollor SH.P.K.**, është e themeluar dhe organizuar sipas ligjeve të Republikës së Kosovës, regjistruar në regjistrin tregtar në ARBK, me Numër Unik Identifikues (NUI) 810504630 dhe me zyrë të regjistruar në adresën: Zona Industriale, Rr. Ymer Elshani, Nr. 51. Aktivitetet e ndërmarrjes përfshijnë: publikimin e librave, publikimin e gazetave, publikimin e revistave dhe veprimtari të tjera botuese.

#### PALËT NË PROCEDURË:

Palë në këtë procedurë të zhvilluar nga Autoriteti, konsiderohet:

1. **Dukagjini SH.P.K.**, është e themeluar dhe regjistruar në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (ARBK), me Numër Unik Identifikues (NUI) 810418922, dhe zyrë të regjistruar në adresën, Rr. Ismail Qemali, Nr. 2, Pejë, Kosovë. Aktivitetet e ndërmarrjes përfshijnë sektorin e botimit dhe shitjes së librave në territorin e Republikës së Kosovës.
2. **Shtëpia Botuese Libri Shkollor SH.P.K.**, është e themeluar dhe organizuar sipas ligjeve të Republikës së Kosovës, regjistruar në regjistrin tregtar në ARBK, me Numër Unik Identifikues (NUI) 810504630 dhe me zyrë të regjistruar në adresën: Zona Industriale Rr. Ymer Elshani, Nr. 51. Aktivitetet e ndërmarrjes përfshijnë: publikimin e librave, publikimin e gazetave, publikimin e revistave dhe veprimtari të tjera botuese.

#### Baza Ligjore dhe akti i Përqendrimit:

Sipas nenit 13, të Ligjit 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës, përmbushet detyrimi për të bërë njoftimin e Përqendrimit pasi që:

- a) Qarkullimi në tregun e brendshëm, kalon shumë 3,000,000 Euro;
- b) Marrëveshja për Shitblerjen e Aksioneve, ndërmjet Dukagjini SH.P.K. dhe Libri Shkollor SH.P.K, e lidhur me datë, 29.07.2024;
- c) Kërkesa për përqendrim, është bërë për arsye se shitësi dhe blerësi janë prezent në territorin e Kosovës, dhe transaksioni bie në dispozitat e LMK-së;

N.B

J.A. SGL

Pas pranimit të Njoftimit për Përqendrim, e paraqitur në bazë të Ligjit 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe bazuar në nenet 11, 13, 17, 18, si dhe Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2023, për Procedurën e Parashtrimit të Kërkesave për Lejimin e Përqendrimit dhe Kriteret për Konstatimin e Përqendrimit, Sekretariati ka filluar vlerësimin e kërkesës për Përqendrim.

### Procedurat e ndjekura dhe Aktivitetet e zhvilluara gjatë procedurës hetimore në tregun përkatës

1. Njoftimi lidhur me transaksionin, midis ndërmarrjes Dukagjini SH.P.K. dhe Shtëpisë Botuese Libri Shkollor SH.P.K, i datës, 02.09.2024, me Nr. Prot. 557/24-11/H;
2. Vërtetimi për Kërkesën e Dorëzuar, i datës: 27.09.2024, me Nr. Prot. 648/24-11/H;
3. Njoftimi për realizimin e përqendrimit në ueb faqen e AKRK-së, i datës: **30.09.2024**;
4. Marrëveshja për Shitblerjen e Aksioneve, e lidhur me datë: 29.07.2024, ndërmjet ndërmarrjes Dukagjini SH.P.K. dhe Shtëpisë Botuese Libri Shkollor SH.P.K;
5. Përgjigje nga ndërmarrja Dukagjini SH.P.K., ndaj kërkesës së AKRK-së për mbledhjen e të dhënave, e datës: 11.10.2024 me Nr. Prot. 679//24-11/H;
6. Konkluzion për fillimin e procedurës për vlerësimin e përqendrimit, i datës: 28.10.2024, me Nr. Prot. 703/24-11/H;
7. Përgjigje nga ndërmarrja Dukagjini SH.P.K., ndaj konkluzionit për fillimin e procedurës, për vlerësimin e përqendrimit e datës: 29.11.2024, me Nr. Prot. 760/24-11/H;
8. Përgjigje nga ndërmarrja Dukagjini SH.P.K., ndaj kërkesës së AKRK-së për mbledhjen e të dhënave, e datës: 09.12.2024, me Nr. Prot. 785//24-01/H;
9. Procesverbali i takimit i datës 17.12.2024, mbajtur me Drejtorin e Shtëpisë Botuese "Libri Shkollor", z. Bajram Shatri;
10. Informatat shtesë të datës 18.12.2024 me Nr. Prot. 812//24-09/H, nga Shtëpia Botuese Libri Shkollor SH.P.K;

### TREGU PËRKATËS

**Tregu gjeografik** - duke iu referuar nenit 4, 6 dhe 7 të Udhëzimit Administrativ, për përcaktimin e tregut përkatës, Nr. 01/2023, bazuar në analizën e këtij rasti, tregu gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Kosovës.

**Tregu përkatës i produktit përfshin:** sektorin e botimit dhe shitjes së librave shkollorë, në territorin e Republikës së Kosovës.

### Struktura e Aksionarëve pas përqendrimit

Ndërmarrja **Dukagjini SH.P.K.** do të jetë pronare e 100% të aksioneve, të **Ndërmarrjes Libri Shkollor SH.P.K**

### Qarkullimi vjetor sipas pasqyrave financiare të vitit 2022

Nr.	Emri i Ndërmarrjeve	Qarkullimi vjetor
1.	Dukagjini SH.P.K.	██████████ €
2.	Libri Shkollor SH.P.K	██████████ €

*N.B*

*J.M.*

*SOZ*

## Qarkullimi vjetor sipas pasqyrave financiare të vitit 2023

Nr.	Emri i Ndërmarrjeve	Qarkullimi vjetor
1.	Dukagjini SH.P.K.	██████████€
2.	Libri Shkollor SH.P.K	██████████€

Bazuar nga të dhënat e ofruara nga palët në përqendrim, arsyet të cilat kanë ndikuar në rënien e qarkullimit nga viti 2022 në raport me vitin 2023, (provë: Pasqyrat Financiare të hyrat për vitin 2023 kanë qenë ██████████€, ndërsa në vitin 2022, ishin ██████████€).

Arsyet të cilat kanë ndikuar në rënien e qarkullimit nga viti 2022 në raport me vitin 2023, janë të listuara si më poshtë:

Në vitin 2022, Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), ka blerë të gjitha librat shkollorë për klasat nga I deri në IX, duke siguruar sasi të mjaftueshme për secilin nxënës, aq sa ishte numri i përgjithshëm i tyre.

Në vitin 2023, MASHTI ka ndryshuar vendimin, duke implementuar një skemë subvencioni për prindërit, për blerjen e librave shkollorë, që përfshinte vetëm klasat nga I deri në V.

Në kuadër të kësaj Shtëpia Botuese "Libri Shkollor" të miratuara ka gjithsej, 18 tituj:

- Për klasat I deri në V: 6 tituj.
- Për klasat VI deri në IX: 12 tituj.

Ndërkaq, shitjet më të larta të librave të shtëpisë botuese Libri Shkollor, përfshijnë:

- Librat e Fizikës për klasat VI, VII, VIII dhe IX.
- Librat e Kimisë për klasat VII, VIII dhe IX.

Ndryshimi në modelin e shpërndarjes dhe financimit të librave ka ndikuar në rënie të qarkullimit për Shtëpinë Botuese Libri Shkollor. Në vitin 2022, blerjet qendrore të realizuara nga Ministria kanë mundësuar furnizim të plotë. Në vitin 2023, me kalimin në skemën e subvencionimit të prindërve, është ulur ndjeshëm volumi i furnizimeve direkte nga shtëpia botuese.

Me datën 17.12.2024, Autoriteti i Konkurrencës ka zhvilluar takim me Drejtorin e Shtëpisë Botuese "Libri Shkollor", z. Bajram Shatri. I njëjti ka deklaruar se, arsyeja e shitjes së aksioneve të ndërmarrjes, Shtëpia Botuese Libri Shkollor SH.P.K, ishte se e njëjta gjendet në prag të falimentimit, për shkak të tregjeve alternative, që nga viti 2023.

Ndërmarrja Shtëpia Botuese Dukagjini SH.P.K. duke u bazuar në të dhënat e Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve (ARKB), operon me një njësi në qytetin e Pejës.

Ndërmarrja Shtëpia Botuese Libri Shkollor SH.P.K., duke u bazuar në të dhënat e Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve (ARKB), operon me një njësi në qytetin e Prishtinës.

**Aktivitetet e Ndërmarrjes, Shtëpia Botuese Dukagjini SH.P.K. dhe Shtëpia Botuese Libri Shkollor SH.P.K., në tregun e Kosovës:**

N.B

J.M.

SGC

**Dukagjini SH.P.K.**, është themeluar dhe regjistruar në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (ARBK), me Numër Unik Identifikues (NUI) 810418922, dhe zyrë të regjistruar në adresën, Rr. Ismail Qemali, Nr. 2, Pejë, Kosovë. Aktivitetet e ndërmarrjes përfshijnë sektorin e botimit dhe shitjes së librave në territorin e Republikës së Kosovës.

**Shtëpia Botuese Libri Shkollor SH.P.K.**, është e themeluar dhe organizuar sipas ligjeve të Republikës së Kosovës, regjistruar në regjistrin tregtar në ARBK me Numër Unik Identifikues (NUI) 810504630 dhe me zyrë të regjistruar në adresën: Zona Industriale, Rr. Ymer Elshani, Nr. 51. Aktivitetet e ndërmarrjes përfshijnë: publikimin e librave, publikimin e gazetave, publikimin e revistave dhe veprimtari të tjera botuese.

#### Forma juridike e Përqendrimit

Njoftimi për Përqendrim ka të bëjë me blerjen e 100% të aksioneve, të **Shtëpisë Botuese Libri Shkollor SH.P.K.**, nga **Shtëpia Botuese Dukagjini SH.P.K.**

Kërkesa për përqendrim është bërë vetëm në Autoritetin e Konkurrencës të Republikës së Kosovës, për arsye se ndërmarrjet janë vendore.


Ndryshimi i vetëm në ndërmarrje, është bartja e aksioneve nga **Shtëpia Botuese Libri Shkollor SH.P.K.**, tek **Shtëpia Botuese Dukagjini SH.P.K.**

#### Historiku i Ndërmarrjes Dukagjini SH.P.K

Dukagjini SH.P.K. është ndërmarrje rajonale, aktualisht operon në disa industri, si në librari, shtypshkronjë, shtëpi botuese, edukim, inxhiniering, restaurant, ndërtimtari, hotelieri, shërbime fiskale, në Kosovë dhe Shqipëri.

Ndërmarrja Dukagjini SH.P.K., ka bërë marrëveshje premtimesh reciproke, me ndërmarrjen Shtëpia Botuese Libri Shkollor SH.P.K., e cila ia blen të gjitha kuotat e aksioneve të aksionarëve, që përbëjnë çmimin e tërësishëm prej [REDACTED] EU. Çmimi do të paguhet individualisht tek aksionarët, në përputhje me përcaktimet e kontratave individuale, për shitblerjen e aksioneve.

**Kontrulli i ndërmarrjes Shtëpia Botuese Dukagjini SH.P.K., pas kryerjes së transaksionit mbi Shtëpia Botuese Libri Shkollor SH.P.K.**



**Struktura e tregut përkatës lidhur me sektorin e botimit dhe shitjes së librave për vitin 2023**

Nr.	Emri i Ndërmarrjeve	Qarkullimi vjetor	%
1.	Dukagjini SH.P.K.	[REDACTED] €	[REDACTED]
2.	/	x €	[REDACTED]
3.	/	x €	[REDACTED]
4.	/	x €	[REDACTED]
5.	Libri Shkollor SH.P.K	[REDACTED] €	[REDACTED]

5

U.P.B

F.M.

SGK

6.	/	x €	
		€	

## ANALIZA E KONKURENCËS

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës, me datë: 28.10.2024, me Nr. Prot. 703/24-11/H ka marrë konkluzion për fillimin e procedurës, për vlerësimin e përqendrimit ndaj ndërmarrjes Dukagjini SH.P.K. E njëjta brenda afatit ligjor, ka dërguar komentet. Autoriteti i Konkurrencës ka analizuar komentet dhe dokumentacionin e lëndës, pas analizimit të të dhënave nga ndërmarrja Dukagjini SH.P.K, e cila forcon pozitën dominuese në tregun përkatës, bazuar në nenin 8 Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, ndërmarrja sipas qarkullimit vjetor në tregun përkatës në vitin 2023, ka pozitë dominuese përfaqësisht 72.94%.

Sipas indeksit Herfindahl-Hirschman (HHI), për vitin 2023, përqendrimi i ndërmarrjeve në tregun relevant është 5,739.44 (i Lartë).

Konkurrenca pas përqendrimit nuk pengohet, sepse pozita dominuese e ndërmarrjes Dukagjini SH.P.K, nuk forcohet ndjeshëm pas përqendrimit, për shkak se: Shtëpia Botuese Libri Shkollor SH.P.K., në vitin 2023 në tregun përkatës kishte pjesëmarrje rreth 1.68 %, kjo ndërmarrje ka pjesëmarrje relativisht të vogël dhe për këtë arsye nuk mund të jetë një forcë e rëndësishme, e cila pas përqendrimit të mund të ndikojë negativisht në këtë treg.

Rritja e çmimeve në tregun përkatës është e kufizuar, për shkak se ndërmarrjet konkurruese/rivale prodhojnë libra shkollor të përafërt me pjesëmarrësit në përqendrim (alternativ). Autoriteti konsideron se ka pak gjasa që një përqendrim në këtë treg përkatës, të shtrembërojë konkurrencën edhe pse ndërmarrja “Njoftuese” forcon pozitën dominuese, për arsye se: ekziston një shkallë e lartë e zëvendësueshmërisë midis produkteve të pjesëmarrësve në këtë përqendrim dhe atyre të furnizuar nga prodhuesit rivalë, po ashtu nga sa më lartë edhe nga përqendrimi i njoftuar ndërmarrja Target nuk ka pozicion/strukturë domethënëse, e cila do të mund të ndikonte në forcimin e pozitës dominuese të blerësit.

Autoriteti konsideron se, ndërmarrjet të cilat prodhojnë dhe shesin librat shkollor, sipas legjislacionit primar dhe sekondar, janë të detyruara t’i zbatojnë çmimet e miratuara nga (MASHTI), në përputhje me qëllimet dhe objektivat e politikave publike në arsim. Ndërmarrja Dukagjini SH.P.K, nuk ka mundësi t’i mbajë çmimet mbi nivelin konkurrues dhe nën nivelin e konkurrencës, si dhe ta kufizojë prodhimin apo ndajë tregun. Transparenca në këtë treg është e lartë, për shkak se të gjitha ndërmarrjet në tregun përkatës, ofertojnë me titujt e teksteve shkollore, përmes ofertave transparente dhe thirrjeve publike nga MASHT.

Autoriteti konsideron se në këtë treg, inovacioni është një forcë e rëndësishme konkurruese, ky përqendrim mund të rrisë aftësinë dhe nxitjen e ndërmarrjeve të tjera për të sjellë risi të reja në treg dhe në këtë mënyrë, rritet presioni konkurrues ndaj rivalëve për t’u kyçur në atë treg.

Bazuar në nenin 11 paragrafin 4, nën paragrafi 4.3 i Ligjit Nr. 08/L-056, për Mbrojtjen e Konkurrencës ndër të tjera (inter alia), nuk quhen përqendrim i ndërmarrjeve sipas këtij neni, nëse “bartja e kontrollit të ndërmarrjes të administratori falimentues ose likuidatori, në përputhje me legjislacionin në fuqi”, që nënkupton se ndërmarrja shtëpia botuese Libri Shkollor, në rast se do të shpallte falimentimin, atëherë nuk do të paraqitej nevoja për të parashtruar kërkesë për përqendrim. Andaj nga sa më lartë, Autoriteti vlerëson se, si do që të jetë tregu, respektivisht nga një situatë e tillë, përfundimisht do të rezultonte me një ndërmarrje më pak në tregun përkatës.

V.P.B

J.M. SGL

Autoriteti bazuar në pasqyrat financiare deklarimet dhe dëshmitë e ofruara nga përfaqësuesit e Shtëpisë Botuese Libri Shkollor SH.P.K., vlerëson se ky përqendrim lejohet sepse pjesëmarrësi në përqendrim, ndërmarrja, Shtëpia Botuese Libri Shkollor SH.P.K., është duke dështuar sepse;

- Së pari, ndërmarrja në dështim e sipër në të ardhmen e afërt, do të dëbohej nga tregu për shkak të vështirësive financiare, nëse nuk merret përsipër nga një ndërmarrje tjetër;
- Së dyti, nuk ka asnjë blerje alternative më pak konkurruese, se sa përqendrimi i njoftuar.
- Së treti, në mungesë të një përqendrimi, asetet e ndërmarrjes në dështim, do të dilnin në mënyrë të pashmangshme, nga tregu.

Autoriteti i Konkurrencës duke pasur parasysh lejimin e këtij përqendrimi me pozitë dominuese, si dhe me qëllim të sigurimit të sjelljes efektive konkurruese të palëve në përqendrim, vendosi si në pikën II të dispozitivit, ku ndërmarrjen Dukagjini SH.P.K., do ta mbajë në monitorim për një periudhë tri vjeçare dhe për çdo formë të shtrembërimit të konkurrencës, respektivisht sjellje anti - konkurruese, do të ndërmerren veprimet ligjore bazuar në Ligjin Nr. 08/L-056, për Mbrojtjen e Konkurrencës, ku mund të shpie edhe në shfuqizimin e lejimit të përqendrimit.

Nga sa më lartë, Komisioni i Autoritetit duke u bazuar në nenin 55 paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 i Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Obligohet Sekretariati që të kujdeset për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e Komisionit.



**Kaltrina Sela**  
Nënkryetare

**Florent Mehmeti**  
Anëtar

**Nafije Osdautaj**  
Anëtare

**Salihe Gashi Loku**  
Anëtare

Me këtë Vendim të njoftohen:

- Palët
- Arkiva